



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:030049

Datë: 20.01.2022

Numri i dokumentit: 02627564

V.Ek.nr.101/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit kompania e sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ligjshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve në procedurë të ndërmjetësimit me nr.ref. Nd.581/21 të datës 18.01.2022, jashtë seancës, me datë 19.01.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit me nr.ref. Nd.581/21, e lidhur mes këtu paditëses kompania e sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë dhe të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, me datë 18.01.2022 në Zyrën për Ndërmjetësim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kthimin e borxhit.

II. Marrëveshja e lartcekur merr fuqinë e titullit përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësja kompania e sigurimeve [“S...”], me seli në Prishtinë me datë 16.02.2021, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kthimin e borxhit në lartësi prej 212.40 euro.

Në seancën e datës 21.12.2021, në kuptim të nenit 411 të LPK-së, gjykata i ka njoftuar palët ndërgjyqëse lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes procedurës së ndërmjetësimit. Pasi të njëjtit janë pajtuar për shfrytëzimin e kësaj metode alternative për zgjidhjen e kontestit, gjykata me aktvendim procedural e ka referuar këtë çështje kontestimore në procedurë të ndërmjetësimit.

Zyra për Ndërmjetësim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka njoftuar se këtu palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje mes vete në procedurë të ndërmjetësimit dhe gjykatës i ka dorëzuar Marrëveshjen e Ndërmjetësimit nr.ref. Nd.581/21, të lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse me datë 18.01.2022.

Gjykata pasi konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa me të cilat palët ndërgjyqëse mund të disponojnë lirisht, se marrëveshja konkrete e ndërmjetësimit nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore relevante dhe se gjatë procedurës së ndërmjetësimit nuk janë

cenuar të drejtat apo interesat e palëve, e aprovoi marrëveshjen e arritur mes palëve pranë organit të ndërmjetësimit.

Mbi bazën e të lartcekurave, e në pajtim me nenin 3.3, 411 të LPK-së, me nenin 15 par.1 të Ligjit *Nr.06/L-009* për Ndërmjetësimin, si dhe me nenin 17 par.1 të Rregullores Nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, e nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
V.Ek.nr.101/21, datë 19.01.2022

Gjyqtari
Faton Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa